



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:236859

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06518357

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.774/21

GJYKATA THEMELORE NË PËJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit V. A., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1884/21 të datës 20.10.2021, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 184 par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datat 13.12.2023, 29.01.2024, 21.03.2024 dhe seanca e fundit me datë 14.11.2024, e mbajtur në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi dhe të pandehurit V. A. me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Blerim Ademaj si dhe të dëmtuarit I. A., me datë 15.11.2024 shpalli ndërsa me datë 26.11.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

V. A., i atësisë S., dhe amësisë H. e gjinisë M., i lindur më, në fsh. R. Komuna Pejë, me vendbanim në V.Rajoni II-të, rr. A. I., jeton dhe punon në Gjermani , ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën. 20.08.2021, rreth orës 16:00 në fsh. R. K. Pejë, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit I. A., pas një mosmarrëveshje lidhur me ndarjen e pronës së përbashkët që kanë i dëmtuari I. dhe i pandehuri V. të cilët janë vëllezër, i pandehuri V. me qëllim të frikësimit, e kanos të dëmtuarin

me fjalët kanosëse “Ose nënshkruaje procesin e ndarjes së pronës, ose kam me të prerë në fyt”, ku fjalët e të pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, dhe pasiguri se me të vërtetë do ti ndodh diçka e keqe nga ana e të pandehurit.

- me këtë ka kryer veprë penale “Kanosje” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit V. A. i shqipton:

- I. DENIM ME GJOBË në lartësi prej 2,000 (dy mijë) euro, të cilin detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- III. I dëmtuari I. A. nga fsh. R. Komuna Pejë udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate me datë 20.10.2021, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1884/21 kundër të pandehurit V. A. për shkak të veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datat 13.12.2023, 29.01.2024, 21.03.2024 dhe seanca e fundit me datë 14.11.2024, në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-

Gacaferi dhe të pandehurit V. A. me mbrojtësin sipas autorizimit Av.Blerim Ademaj si dhe i dëmtuari I. A..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata i administroj provat e propozuara nga prokurori i shtetit dhe nga mbrojtësi i të pandehurit, qe përfshin dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e provave materiale, në bazë të të cilave prova gjykata e nxori përfundimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në arsyet si në vijim.

I pandehuri V. A. është shpallur fajtor për shkak se më veprimet e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Vepra penale e lartpërmendur ka këtë përshkrim ligjor:

1. Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

2. Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Vepra penale e kanosjes hynë në kuadër të veprave penale kundër jetës dhe trupit e cila kryhet përmes deklarimit verbal, në formë të shkruar apo me gjeste të ndryshme, përmes të cilave i bëhet me dije personit tjetër se do ti shkaktohet ndonjë e keqe, e gjithë kjo me qëllim të shkaktimit të ankthit apo frikës.

Kërkohet që kanosja e drejtuar të kanosurit të jetë serioze, të jetë e mundshme dhe të jetë e tanishme. Se kur një kanosje konsiderohet serioze, përcaktohet nga rrethanat e secilit rast, duke marrë parasysh se nga kush bëhet kanosja, përkatësisht a ka mundësi objektive ky person ta realizojë dëmin e kanosur, kohën dhe momentin në të cilën bëhet kanosja, a bëhet në një periudhë të acaruar marrëdhëniesh në mes të kryerësit dhe të kanosurit apo në një moment humori, e gjithashtu serioziteti i të keqes që bëhet me dije të kanosurit del edhe nga motivi mbi të cilën mbështetet dashja e kryerësit për të kanosur personin tjetër, e shumë rrethana të tjera.

Pastaj duke marrë parasysh faktorët e lartpërmendur dhe shumë faktor të tjerë objektiv dhe subjektiv, kërkohet që e keqja e kanosur të jetë e mundshme, pra ka rëndësi fakti se kryerësi i kësaj vepre penale a ka mundësi që ta shkaktoj të keqën e kanosur, apo a ka mundësi objektive që e keqja e kanosur ti shkaktohet të dëmtuarit, e nëse këto rrethana janë ekzistuese ndikojnë që te i kanosuri të shkaktoj frikën dhe ankthin, me çka edhe realizohet qëllimi i kryerësit të kësaj vepre penale.

Paragrafi 2 i kësaj vepre penale paraqet rrethana kualifikuese, e që shprehet përmes rasteve kur e keqja e shkaktohet të kanosurit ka të bëjë me privimin nga jeta, shkaktimin e lëndimeve të rënda, rrëmbimin, privimin nga liria, përkatësisht veprime të cilat paraqesin një shkallë shumë të lartë të rrezikshmërisë për jetën, integritetin trupor dhe lirinë e personit të kanosur.

B. Vendimi në lidhje me fajësinë;

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të aktakuzës gjykata e zhvilloj seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë u administruan provat e propozuara nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësit, përkatësisht u dëgjuan në cilësi të dëshmitarëve I. A., E. A., S. A. S., M. A. dhe Sh. Sh. si dhe janë administruar provat materiale, raporti fillestar i incidentit me nr. rasti 2021-DA-..., i dt. 20.08.2021, raporti i oficerit B.B. i dt. 20.08.2021, raporti i hetuesit E. S. i dt. 20.08.2021, deklarata e te dëmtuarit I. A. e dhënë në polici me dt. 20.08.2021, deklarata e dëshmitares E. A. e dhënë në polici me dt. 20.08.2021, deklarata e pandehurit V. A. e dhënë në polici me dt. 20.08.2021, procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i dt. 20.08.2021, si dhe 3 CD-të dorëzuara nga i pandehuri dhe 1 CD të dorëzuara nga i dëmtuari .

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit I. A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.13.12.2023 duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit deklaroi “se kam jetuar në fsh.R., Komuna Pejë me bashkëshorten katër fëmijët dhe me dy prindërit e ndjerë të cilët kanë ndërruar jete në vitin e kaluar, ndërsa tash jetoj me bashkëshorten dhe me fëmijët. Ditën kritike me dt. 20.08.2021 rrethe orës 16:00 isha në shtëpi duke u kujdesur për prindin tim i cili ishte i palëvizshëm, ku atë ditë kanë qenë prezent bashkëshortja ime dhe katër fëmijët e mijë. Tutje i njëjti deklaroi se isha në dhomën e prindit duke u kujdesur për të, fillimisht kam dëgjuar zërin e V. s në dhomën e pritjes duke kërcënuar bashkëshorten time me dI. fjalë, mirëpo nuk e kam dëgjuar mirë, ku papritmas kam dëgjuar kur ka ardhë në dhomën e babës e ka hap derën me këmbë duke ju drejtuar babës me fjalë fyese që nuk bon me thënë as kush prindit e më pas ka provuar në sy të prindit të me

sulmoj, më pas bashkëshortja ime ka vrapuar nga prapa dhe e ka tërhequr V. n dhe unë fillova ti shmangem për mos me ardhë deri të e keqja jam nisë për katin e dytë dhe kam qëndruar aty ndërsa V. u ka qenë në korridor ka pasur një thikë në dorë diku për afërsisht 20 cm, duke më thënë se ka me të pre në fyte e gjithë kjo në sy të fëmijëve ku më pas vajza e madhe e ka lajmëruar rastin në policinë, sa i përket thikës pse nuk e kam deklaruar se i njëjti ka qenë me thikë, nuk e di pasi që nuk mu ka dhënë rasti me përmendë se të njëjtën ditë na kanë ardhur policia në bastisje dhe gjithçka është përfunduar pa kurrfarë dëshmime edhe pse unë dhe bashkëshortja ime e kemi detyruar vajzën me terhek rastin dhe jemi munduar me mshefë si rast dhe mos me ardhë deri këtu.

Duke u përgjigjur në pyetjen e mbrojtësit të të pandehurit V. , i dëmtuari dëshmitari deklaroi se përveç anëtarëve të familjes sime, sa kanë qenë prindërit gjallë na kanë vizituar anëtarët të tjerë të familjes motrat dhe vëllezërit vizita të shkurtër përjashtimisht vëllait të madhe i cili më ka ndihmuar në kujdesin e prindërve.

Duke u përgjigjur në pyetjen e të pandehurit pse nuk ka deklaruar në polici për thikë që ka pasur në dorë i pandehuri, dëshmitari u përgjigj se kam dashur me mbyllë atë ditë me hekë lëndën pasi që ishte vëllau, tutje i pandehuri V. e pyeti, se xhamat në korridor dhe gjanat tjera ai kam thy unë apo vajza e juaj E.-dëshmitari u përgjigj i ka thy V. a ku përveç prindërve kanë qenë dëshmitar bashkëshortja dhe fëmijët e mi.

Gjykata e pyet të dëmtuarin - Gjatë këtyre diskutimeve në të cilat pretendohet së është bërë edhe kanosja a ka qenë prezent gjatë gjithë kohës bashkëshortja e juaj?-i njëjti deklaroi se Po,. Tutje e pyet se Ju thatë se V. ja ka pas thikë në dorë, a mundesh me na përshkrua se çfarë thike ka qenë -dëshmitari thotë se ka qenë thikë kuzhine por ka qenë thikë dy pjesësh e që ka mbajtur gjithë here me veti. Tutje e pyet-Gjatë diskutimit ditën kritike se e ka mbajtur thikën?-dëshmitari përgjigjet, e ka mbajtur thikën në dorë ku dhe ka tentuar me më sulmua edhe me thikë.

Duke shtuar se përveç këtij rasti ne i kemi pas edhe 80 kërcënime përgjatë dy viteve, mirëpo ne jemi munduar me ja mbulua për shkak të prindërve.

Gjykata e vlerësoj dëshminë e këtij dëshmitare dhe gjeti se e njëjta është bindëse, është në kohezion me dëshminë dhënë në polici, nuk ka asnjë kontradiktë brenda përbrenda sajë e as me dëshminë paraprake, kjo dëshmi përputhet edhe me dëshminë e të dëmtuarës dëshmitares E. A.j

pasi qe faktet e njëjta qe të dy i përshkruajnë në mënyrë të njëjtë e qe ka te beje natën kritike rreth përleshjes , andaj gjykata ja fali besimin e plotë kësaj dëshmie dhe përmes saj vërtetohet se pas një mosmarrëveshje lidhur me ndarjen e pronës së përbashkët që kanë i dëmtuari I. dhe i pandehuri V. të cilët janë vëllezër, i pandehuri V. me qëllim të frikësimit, e kanos të dëmtuarin me fjalët kanosëse “Ose nënshkruaje procesin e ndarjes së pronës, ose kam me të prerë në fytyrë”, ku fjalët e të pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, dhe pasiguri se me të vërtetë do ti ndodh diçka e keqe nga ana e të pandehurit, gjithashtu përputhet edhe me provat tjera të administruara.

Dëshmitarja E. A. në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 29.01.2024, duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit deklaroi se “ditën kritike dt.20.08.2021 kam qenë në shtëpi rreth orës 16:40 e kam dëgjuar derën e oborrit që është hap dhunshëm nga V. ja e që kjo ka ndodhur dI. herë të tjera, më pas ka ardhë brenda në shtëpi dhe menjëherë ka shkua në dhomën ku ka qenë gjyshi dhe babi dhe ka fillu me bërtit me shajtë një fjalë që kam ndi ka qenë “kom me të pre në fytyrë o qen”, ku ja kam nisë me shumë mu shqetësua, jem mbledhur krejt familja, unë mami, vëllai i vogël 6 vjeç dhe motra 10 vjeç, kam pa diçka që V. ja ka pas të dyshimtë në shpinë-pas shpine në dorë, e gjithë kjo ka ndodhur në sy të vëllait dhe motrës së vogël, ka vazhduar me sharje dhe ofendime dhe unë jam tutë shumë se po ndodhë diçka, kur e kam pa vëllain dhe motrën tu qajhtë ku ja kam nisë mu bë edhe me keq, ku më pas kam marr vëllain dhe motrën dhe i kam larguar, kam dalë jashtë duke u dridhur, kam pas ankth dhe panik e cila ka mujtë me u vrejtë dhe në thirrjen që ja kam bërë policisë.

Prokurori e ballafaqoi dëshmitaren me deklaratën e dhënë në polici me datë 20.08.2021, ku në faqen nr. 2 rreshti i 10-të, nderë të tjera ka deklaruar se " kur unë e thirra policinë axha deshti të më pengoj sikur herën e kaluar rreth 3 muaj më parë, mirëpo unë dola jashtë dhe bisedova me policinë".- Cila është e vërteta?-dëshmitari u përgjigj, " Fillimisht ka kaluar shumë kohë prej asaj ngjarje dhe është e vërtetë se edhe një here para kësaj kam tentuar me thirre policinë dhe më ka ndal por herën e dytë nuk e ka ditë pasi që kam dal jashtë.

Prokurori pyet dëshmitaren “Ju ditën kritike keni pasur një lëndim në dorë si pasoj e ç’kafit erdhi ai lëndim?-dëshmitarja përgjigjet “nuk më kujtohet shumë por me duket se kur jam dal nga shtëpia tu ikë e kam tesh për cep të derës. Në pyetjen e radhës së prokurorit se “A keni tentuar ditën kritike që të ndaloni axhën në ndonjë moment kur i njëjti i është drejtuar të dëmtuarit?-

dëshmitarja u përgjigj “Nuk me kujtohet por e di se mami e ka kap dhe e ka larguar për mos me ndodhë diçka e keqe”.

Prokurori e ballafaqoi dëshmitaren me një pjesë të deklaratës së saj të dhënë në polici në rreshtin e 11 në faqen 2, ku e njëjta ka theksuar se "unë e kam lënduar dorën e majtë duke provuar të ndaloj axhën që mos ta sulmoj babain dhe në një moment e kam rrezuar një set të filgjanave ".- atëherë na tregoni se cila është e vërteta ajo që deklaruat më parë apo se dorën e keni lënduar në momentin që keni ndërhyrë që ta ndaloni axhën mos ta sulmoj babain tuaj?-dëshmitarja u përgjigj, “nuk me kujtohet”.

Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të pandehurit e njëjta deklaroi se momenti kritik ka ndodhë në dhomën e gjyshit, nuk e di a ka qen dikush tjetër i lënduar pasi që unë kam dalur jashtë, sa i përket të pandehurit, i njëjti ka pas thikë (e njëjta tregon me duar gjetësin e thikës sipas vlerësimit të lire) diku rreth 10-15 cm. Tutje e njëjta përgjigjet se pasi që e kam lajmëruar policin kanë ardhur pas 20-25min, ku të pandehurin V. e kanë marrë Policia.

I pandehuri pyet dëshmitaren, A i keni thirrur nga oborri apo nga korridori (i pandehuri shton se dëshmitarja ka qenë ulur këmbëkryq tuj kajt e ku ka thënë hajde se po don me na mbyl babain axha)?-dëshmitarja përgjigjet, unë e kam thirrur nga oborri. Në pyetjen e radhës të pandehurit a me ke thënë se axhë mu dhimte por nuk pata çka me bo?-dëshmitarja u përgjigj: “jo nuk është ashtu”.

Gjykata e pyet dëshmitaren – Meqenëse gjyshi e gjyshja kanë jetuar në shtëpi tek ju, a mundesh të na tregoni a ka ardhur këtu i pandehuri V. për të vizituar ndonjëherë?-e njëjta përgjigjet se rreth një viti rresht kanë ardhur dy here në javë. Tutje e pyet se gjatë vizitave a keni dëgjuar me herët të kanë pasur diskutime apo konfortime ndërmjet V. s dhe I.? -dëshmitarja thotë se “Po çdo here sa here kanë ardhë, kanë pasur diskutim rreth çështjes pronësore, sa here që ka ardhë V. a ka shkuar vetëm në dhomën të gjyshja, e kur ka shkuar të gjyshi i njëjti gjithmonë ka kërcënuar me fjalë gjyshin shkaku i pronësisë”.

Gjykata e ballafaqoi dëshmitaren me deklaratën e dhënë në polici me datë 20.08.2021, ju keni deklaruar se me dt.19.08.2021 rreth orës 4:30, derl. po qëndroja në shtëpi e kam dëgjuar axhin V. duke folur me hallën Shkurt, për familjen tonë dhe problemet që i kemi, nder të tjera V. ja i

ka thënë Shkurtes " ai e meriton me pre thikë në fyt" dhe më pas i thotë " kam me e pre në fyte " keni deklaruar kështu? " Po dhe askush nuk ka qenë prezent kur i kam dëgjuar ato fjalë”.

Gjykata e pyet dëshmitaren – Ku me herët deklaruat se V. ja i është drejtuar I. me fjalë “kam me te pre më fyt o qen” a mund të na shpjegoni si ka qenë duke u zhvillua ngjarja-këta dytë a kanë qenë në këmbë, a ka qenë dikush ndërmjet tyre ?-e njëjta përgjigjet “me kujtohet se mami o konë duke e larguar babin dhe axha ka dashtë me ju vërsule, pas këtij momenti unë kam dalë jashtë në oborr pas dI. minutave e di se kanë dalë edhe babai dhe mami ndërsa V. ja ka mbet brenda.

Prokurori pyet dëshmitaren “Sa ka qenë distanca në mes jush dhe të pandehurit V. në momentin kur e keni dëgjuar që i është drejtuar të dëmtuarit me fjalë kanosese?-dëshmitarja përgjigjet dhe ngritët në këmbë (duke u kthyer nga prokurori dhe duke treguar distancën) e që i bie me vlerësim të lirë rrethe 2 metra.

I pandehuri e pyet dëshmitaren, Ju thatë se kinse unë kam mësyre me thikë, ku ka qenë I. në atë moment me gruan e vetë?-dëshmitarja përgjigjet, se “ngjarja ka filluar në dhomën e gjyshit dhe ka vazhduar në korridor”.

Dëshmitarja shton se shumë kohë pas këtij rasti kemi pasur frikë dhe mu ka dashtë shumë kohë me kalua ketë traumë përpos këtij rasti kanë qenë edhe dy here të tjera ku një here e ka marrë karrigen me e gjujtë babin dhe herën tjetër ka shkuar te seti i thikave që e kemi në kuzhinë dhe jemi frikësuar shumë se po na bën diçka.

Gjykata e vlerësoj me vëmendje dëshminë e dëshmitares E. A.dhe erdhi në përfundim se të njëjtës duhet falur besimi në tërësi pasi që kjo dëshmi ne parim nuk ka asnjë kontradiktë brenda përbrenda saj, është në kohezion gjatë gjithë kohës në të gjitha fazat e procedurës dhe është në përputhje të plotë edhe me provat e tjera, duke përfshirë dëshminë e të dëmtuarit, një pjesë të dëshmisë së dëshmitarit I. A. dhe me vetë mbrojtjen e të pandehurit V. A..

Përmes kësaj dëshmie janë vërtetuar dI. nga faktet që lidhen me të pandehurin V. A., kjo dëshmitare ka shpjeguar në mënyrë kronologjike se fillimisht ka dëgjuar derën e oborrit që është hap dhunshëm nga V. ja e që kjo ka ndodhur dI. herë të tjera, më paska ka ardhë brenda në shtëpi dhe menjëherë ka shkua në dhomën ku ka qenë gjyshi dhe babi, dhe ka fillu me bërtit me shajhtë një fjalë që kam ndi ka qenë “kom me të pre në fyt o qen”.

Dëshmia e kësaj dëshmitare është prova ma bindëse me të cilën vërtetohet se i pandehuri V. A. e ka kryer veprën penale të Kanosjes nga neni 181 par.2 të KPPRK-së, pasi që kjo dëshmitare me bindje e konfirmon se e ka dëgjuar të pandehurin V. duke ju drejtuar të dëmtuarit I. “kom me të pre në fyt o qen”, pra kjo dëshmi mbështetet plotësisht edhe nga dëshmia e të dëmtuarit I. A. dhe dëshmia e dëshmitares okulare që ishte prezent gjatë gjithë kohës M. A..

Dëshmitarja S. A. V. në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 29.01.2024, duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të pandehurit deklaroi “atë ditë kur ka ndodhur rasti e kam telefonuar nënën dhe e njëjta me ka treguar se si e ka thirre V. n në telefon dhe ka kërkuar ushqim, ku me pas V. a ka shkuar në shtëpinë e vet pasi që nuk janë të ndarë, këta janë tre vëllezër dhe shtëpinë e kanë bashkë, kanë tentuar njerëzit me i nda dhe gjithë ky problem ka të bëjë me pasurinë. Tutje e njëjta deklaron se nëna i ka thënë se A. i ka thy krejt sendet neper korridor dhe ketë rast ja kane montua V. s dhe ja kanë thirrur policinë, ku i I. dhe M.nuk e kanë lënë nënën me deklarua para policisë pasi që të njëjtit kanë për qëllim veç me ja marrë pasurin V. s. Po ashtu e njëjta përgjigjet se gjatë kohës kur ka qenë nëna në R. i kam vizituar deri sa ka filluar kjo ndarja e pasurisë pasi qe ne jemi shtatë fëmijë dhe të gjithë jemi në kurbet përveç I. se është këtu të cilin e ka mbajte V. a. Kur kanë filluar këto probleme pronësore I. nuk me ka lan me shkua aty pasi që thoshin po i del zot V. së, bile një here me ka ra nder sy të babës dhe nenës e ky me ka kap për flok dhe me ka qit për dere jashtë shtëpisë dhe qashtu ju ka bo edhe motrave tjera”.

I pandehuri pyet dëshmitaren, Ju thatë se dy here me ka ra vllau I. a ke letra të spitalit?- dëshmitarja përgjigjet, “Jo nuk kam letra, bile as nuk e kam lajmëruar policinë se kam dashtë me ju ruajt fryrën prindërve dhe vëllezërve, ku edhe një here ne sy të babës me ka ra ku i njëjti me ka thënë thirre policin por unë kam thënë jo”.

Prokurori pyet dëshmitaren, Na trego ku ke qenë me dt.20.08.2021 rreth orës 16:40 min?- dëshmitarja përgjigjet, se “unë kam qenë në Austri dhe nuk kam qenë prezent ditën kur ka ndodhur rasti”.

Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit lidhur me ndarjen e pasurisë e njëjta deklaron se baba e nona nuk ka nda kurgjo, mirëpo baba ka thonë tona herët V. ja është këtu, O. këtu dhe I. këtu.

Gjykata e pyet dëshmitaren – Ju thatë se ditën kritike nana ju ka njoftuar lidhur me problemin që ka ndodhur, a mund të na tregoni si keni folur me nënën?-e njëjta përgjigjet me nënën kam folur në telefon. Tutje e pyet se çfarë ju tha konkretisht nëna? -dëshmitarja përgjigjet se “më ka thënë se e kanë marrë djalin në polici se M. e ka shti A. me e thirre policinë dhe A. i ka thy krejt sendet në korridor”.

Dëshmitarja shton se si i gjithë ky problem është për pasuri dhe sa ja kanë montua V. së dhe ja kanë ndalu mos me guxua djali në shpi t’vet me shkua dhe ku e ka edhe dhomën e vetë me pajisje e ky nuk guxon me shkua se ja thirre policinë.

Gjykata e vlerësoj dëshminë e kësaj dëshmitare dhe erdhi ne përfundim se kjo dëshmi nuk vërteton ndonjë fakt relevant, pasi që e dëshmitarja ditën kritike nuk ka qenë prezent , por e njëjta ka deklaruar sipas fjalëve të cilat ia ka thënë nena e saj, te cilat ne si gjykatë nuk kemi mundur ti konfirmojmë pasi qe nëna e tyre tashme ka vdekur.

Dëshmitarja M. A. në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 29.01.2024, duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit të shtetit deklaroi “se me dt.20.08.2021 rreth orës16:00 min, isha në sallon me fëmijë, ku më pas ka ardhur V. a, i njëjti hyri në dhomën e prindit të vet babait, aty ishte edhe bashkëshorti im I. duke u kujdesur për prindin e tij pasi qe ky i fundit ishte i palëvizshëm, ku me pas ja nisen mu fjalos mes veti, ashtu që V. ja ka nis me ashpërsi mu fjalos me babën dhe me bashkëshortin duke i thënë bashkëshortit tim “ti je qen, ty kam me të qu në polici kam me ta hek kryet thikë edhe shumë fjalë të tjera” , unë e kam tërhequr bashkëshortin dhe e kam ngjit nelt në dhomën për mos me ardhur deri te më e keqja. Tutje e njëjta deklaroi se V. ja ka qenë tepër i ashpër dhe distanca rreth V. s ka qenë gjysme metra largë dhe të njëjtin e kam par me duar pas shpine konkretisht dorën e djathtë dhe nuk kam mujt me vërejt se çka ka pas në dore pasi që isha duke e tërhequr bashkëshortin, ku më pas vajza e ka lajmëruar policinë duke shtuar se me të pandehurin edhe me parë kanë pasur probleme.

I dëmtuari e pyet dëshmitaren, në atë moment kritik a jam kërcënuar vetëm unë apo edhe baba?-dëshmitarja përgjigjet, se dytë, tutje e njëjta përgjigjet se i dëmtuari edhe më parë ka qenë i kërcënuar nga V. a.

Gjykata e pyet dëshmitaren – A mund të na tregoni se në cilën pjesë të shtëpisë është zhvilluar konflikti verbal në mes I. dhe V. së ?-e njëjta përgjigjet ka filluar në dhomën e plakut pastaj në

korridor të shtëpisë, pastaj kanë nisë fjalët e mdhaja, unë e kam tërhequr I. dhe e kam qu në katin e dytë. Tutje e njëjta përgjigjet se nuk e kam parë se kush i ka thyer pjatat dhe atë ditë V. ja nuk ka diskutua dhe nuk ka kërkuar nga I. që të nënshkruaj letrat për ndarjen e pronës.

Dëshmia e kësaj dëshmitare, e përshkruan ngjarjen se si i pandehuri hyri në dhomën e prindit të vet babait, ku aty ishte edhe bashkëshorti i saj I. duke u kujdesur për prindin e tij pasi që ky i fundit ishte i palëvizshëm, ku me pas ja nisen mu fjalos mes veti, ashtu që V. ja ka nis me ashpërsi mu fjalos me babën dhe me bashkëshortin e saj duke i thënë I. “ti je qenë, ty kam me te qu në polici kam me ta hek kryet thikë”, kjo dëshmi për gjykatën e është bindëse, pasi gjithashtu përputhet plotësisht edhe me dëshminë e dëshmitarit të dëmtuarit I. A., pasi që përmes të dy dëshmimeve konfirmohen saktësisht të njëjtat fakte, po ashtu pasi që e njëjta përputhet edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Dëshmitarja Sh. G. në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 29.01.2024, duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të pandehurit deklaroi: "se në ditën kritike nona më ka thirrë në telefon dhe pas 10 min që ka e kanë marrë policia V. n jam shkuar në shtëpi të nena, ku kjo e fundit me ka thënë se ma murrën djalin policia pa pikë faji pasi që M. i ka thënë A. “Thiri policinë”, pa ju bë kurrigjë V. a . Tutje e njëjta deklaroi se atë ditë nena e ka thirrë V. n me ja pru bukën ku pasi që është hi V. a në dhomë të nenës, e njëjta ka lyp ujë dhe V. ja ka shku me mare ujin në veturë dhe pasi që e kanë parë V. n, A. M. dhe I. i kanë thyer gotat në korridor, kur ka dalë nëna janë ardhë polica dhe e kanë mare V. në se i njëjti ka qenë i pafajshëm pasi që nuk i ka sulmuar ku me pas M. e ka mare nenën të plagosmë dhe e ka marrë dhe e ka shti në dhomë dhe ja ka mbyll derën dhe se ka lënë me tregu ngjarjen e vërtet.

Prokurori pyet dëshmitaren, na trego se çfarë konkretisht kishte dëgjuar nëna e juaj në momentin kur i pandehuri V. kishte hyrë në shtëpi?-dëshmitarja përgjigjet, ajo e ka ndi Policinë tuj e marrë djalin V. në dhe ajo më ka thënë se asnjë send V. ja nuk e ka bo as nuk i ka sulmu. Në pyetjen e radhës së prokurorit pasi që ju thatë se nëna ka qenë në dhomë na tregoni si ka mundur me pa ngjarjen kur nuk ishte aty?-dëshmitarja u përgjigj: nona ka thënë se nuk ka bërë kurgjo, masi ka shkuar V. ja me marrë ujë në veturë këto i kanë thyer gotat e më pas e kanë ngjuar nënën në dhomë.

I dëmtuari e pyet dëshmitaren, atë ditë a ka qenë në gjendje më të mirë mendore nëna apo baba?-dëshmitarja përgjigjet, nëna ka qenë më mirë, tutje e njëjta përgjigjet se atë ditë nëna e ka shtypur

telefonin për mem thirrë mua dhe pasi që jam shkuar e kam dërguar nënën në spital dhe nuk jam në dijeni se V. a e ka sulmuar babën.

Gjykata e pyet dëshmitaren – ditën që je shkuar në shtëpi të prindërit kënd e ke takuar dhe a kanë qenë duke qëndruar bashkë ?-e njëjta përgjigjet Nona, M., A. she I. të gjithë kanë qenë aty duke qëndruar bashkë në sallon. Tutje e njëjta përgjigjet se fillimisht kanë qenë bashke ku me pas ka qëndruar vetë me nënën dy orë derI. ma ka treguar ngjarjen dhe më pas e kam dërguar të mjeku.

Gjykata e vlerësoj dëshminë kësaj dëshmitare dhe konsideron se kjo dëshmi nuk vërteton ndonjë fakt relevant pasi që e njëjta në ditën kritike nuk ka qenë prezent, ku pasi dy orëve që ka ndodhur ngjarja ka ardhur tek shtëpia e prindërve, ku e njëjta ka deklaruar sipas fjalëve të cilat ia ka thënë nena e saj, ku kjo e fundit ditën kritike as që ka qenë në vendin ku është zhvilluar ngjarja, pasi që ka qenë në dhomën .

I pandehuri V. A. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.21.03.2024 deklaroi Unë të baba e kam pas të ndaluar me hy, sa i përket ditës kritike qaj incizim ku shihet korridori i demulm janë prej çikës së tij ketë e ka dëshmuar edhe motra sipas fjalëve të nënës pasi që u ka thënë gruaja i I. kapi gjuaj pjatat, për babën po shihet se është i manipuluar se baba mu me ka pas mumër një se unë e kam ndërtua me shpi e me krejt në R.. Tutje i njëjti deklaroi se unë kam shkuar të nëna me një këse në dorë, kam hy te baba ju kam qu me hanger, nëna me tha “ku ma le ujin, a ma prunë ujin”, jam dal me mare ujin, e ky ja ka nis me kërcënime “ik delem prej ktuhit se ta bëjë kshtu e kshtu” në momentin kur kam dal me mare ujë në kerr kam ndi tuj kersitë, më pas jam hy në korridor e çika e tije ka qenë ulur komb kryq tuje fol me policinë duke ju thënë policisë “hajdeni se axha po donë me ma mbyt babën” I thash pse e thirre policinë çka bone kështu në korridor nuk ka fol aty, kur ka dal jashtë me ka thënë “axhë mu dhimte por nuk pata çka me bo” qaty jam shkua te nëna apat, pastaj janë ardhë policia dhe më kanë marrë këta kishin pas bo krejt montimin e kësaj situate.

Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurores së shtetit i njëjti deklaroi se me dt. 20.08.2024 në ora 16:00 kam qenë në shtëpinë e babait të ndjerë, dhe në momentin kur kam shkuar në shtëpi ka qenë i dëmtuari I., ndërsa vajza e tij ka ardhë pas 1-2 min më vonë, e cila e ka lajmëruar policinë pasi që i kishte thënë nëna e vetë thirri, thirri policinë a din çka të kam thënë dhe kapi gjuj pijatat, mirëpo unë atë ditë nuk e ka kërcënuar.

Tutje i njëjti deklaroi se sa i përket ingjizimit të babës në CD-së, “se ja kam nxi jetën I.”- baba ka qenë i semuar rënd dhe ka qenë në presion prej tyre dhe çka i ka thënë ky ai ka bërë, po ashtu po për shkak se nuk jam interesuar unë për babën arsyeja ka qenë se mu ka mshel dera mos me muajt me hy te baba si dhe atë natë kur kam shkuar në shtëpinë time pasi që nëna mi ka lyp hapat e tensionit i kam ra ziles nuk ma kanë qel derën e oborrit pastaj i kam mshuar me shkëlëm.

Duke u përgjigjur në pyetjen e gjykatës i njëjti deklaroi që tri vite kam probleme pronësore me Isën lidhur me dy prona në V. dhe R. ku i njëjti ma ka bllokuar pasurinë e 33 viteve që jam kone në gyrbet, sepse ky nuk vjen me u terjek prej fletës poseduese pasi që jena bashkëpronar në atë pronë, pasi që unë e kam shti përkohësisht e ky nuk po vjen me u terjek dhe ky është problemi që shihet në video të cilin kam kërkuar ta zgjedhim **dhe i kam dhënë ultimatim.**

Gjykata e vlerësoj me vëmendje mbrojtjen e të pandehurit V. A. dhe erdhi në përfundim se të njëjtit duhet ti falet besimi pjesërisht. I pandehuri në mbrojtjen e tij e konfirmon në tërësi se ka pasur probleme me të dëmtuarin I., po ashtu e konfirmon se ditën kritike i njëjti ka qenë në shtëpinë e babai të ndjerë në fsh R., po ashtu e konfirmon edhe faktin se ditën kritike pasi që i bie ziles i njëjti i ka mshuar derës me shkëlëm, e që kjo pjesë e mbrojtjes së tij përputhet në tërësi me dëshminë e dëshmitares E. A..

I pandehuri në mbrojtjen e tij e konteston apo e mohon faktin se e ka kanos të dëmtuarin, duke u munduar që për kanosje ta fajëson të dëmtuarin, mirëpo gjykata nuk ja fali besimin një mbrojtje të tillë, pasi që e njëjta është në kundërshtim me provat e tjera që e mbështesin aktakuzën, përkatësisht e kundërta e kësaj që thotë i pandehuri del nga videoincizimi me anë të së cilave shihet mënyra agresive e hyrjes së të pandehurit në shtëpi duke i rënë dhunshëm derës më këmbë, bisedën të cilën e zhvillon më të dëmtuarin dhe babain e ndjerë të tyre ku ky i fundit thotë se ja ke nxi jetën I., po ashtu ky fakt shihet në video ku i pandehuri ka kërkuar nga i dëmtuari që ta zgjidhë këtë problem duke i dhënë ultimatim (gjë që e pranon edhe vet i pandehuri se i ka dhen ultimatim) , për me tepër të gjitha provat duke përfshirë edhe dëshmitarët vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të të pandehurit, andaj gjykata ja fali pjesërisht besimin mbrojtjes së tij pasi që e njëjta ka për qëllim që të shmang përgjegjësinë penale për veprën e kryer.

Prokurorja e shtetit fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ka potencuar mbeti në tersi pranë aktakuzës dhe pretendimeve të shprehura më të, duke shprehur bindjen se më provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është arritur që të vërtetohet në tersi se i pandehuri V. A. e

ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim si rrethana lehtësuese të mos merret asnjë fakt, ndërsa si rrethana renduese të merret fakti se vepra penale është kryer në kuadër të familjes, dashja e lartë si dhe fakti se vepra penale është kryer në prezencën e fëmijëve të mitur të cilët janë shqetësuar tej mase si dhe në prezencë të prindit të moshuar dhe invalid, për të cilin i pandehuri nuk ka pasur fare dhembshuri por përkundrazi ka qenë i përkushtuar për pasuri e jo për shëndetin dhe kujdesin ndaj tij.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaron se në çdo seancë jam njollosur nga i pandehuri dhe jam krenar se jam faqe bardhë se sa i përket prindërve të mijë i kam lënë të gjitha në Evropë për tu kujdesur për prindërit, unë i kam sjellë materialet e miya dhe pres që gjykata të vendosë drejtësi në bazë të tyre.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Blerim Ademaj, në fjalën përfundimtare të përpiluar dhe të dorëzuar me shkrim ka theksuar së “ i mbrojturi me asnjë provë e më as një deklaratë nuk u vërtetua se ka kryer veprën penale në fjalë, pasi që për të provuar veprën e Kanosjes duhet të tregohet që ka pasur frikë të përballeshme dhe kërcënim real për jetën gjë që duhet analizuar me tej duke mbështetur mbrojtjen se këto fjalë të përmendura nuk kanë përmbushur kriteret për kanosje sipas Kodit Penal e këtë e bazoj në deklaratat e dëshmitarëve Sh. dhe S. A.S. e cila deklaratë është në përputhje të plotë me mbrojtjen e dhënë nga i pandehuri i cili asnjëherë nuk ka kanosur vëllain ashtu siç pretendon, mirëpo ky është inskenim nga i dëmtuari së bashku me vajzën dhe gruan e tij lidhur se si të ja përgatisë një rast kinse i njëjti e ka kanosur. Dhëshmit e të dëmtuarit I. A. dhe dëshmitares Eduarta Ademaj përmbajnë ndryshime të rëndësishme që mund të vihen në dukje për të dobësuar qëndrueshmërinë e aktakuzës, pasi që I. deklaron në polici që kërcënimi për jetë i është bërë në prani të fëmijëve ti tij duke përfshi sulmin fizik ndërsa E. përmend vetëm kërcënime verbale pa përmendur sulm fizik në një mënyrë që qartë përputhet me fjalët e të pandehurit, ndërsa deklaratat e të dëmtuarit është në kundërshtim të plotë me deklaratën e dëshmitares E. dhe dëshmitarëve tjerë. Andaj i propozoj gjykatës që të liroj nga aktakuza të pandehurin V. A. për veprën penale për të cilën akuzohet pasi që nuk u vërtetua se provat relevante për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë si i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me këtë aktakuzë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaron se e përkrah deklarinimin e mbrojtësit tim, është deklarata në polici ku dëshmitarja thotë se i kam thyer ato pijata, kurse kur i shikua video

incizimet tha nuk e di kush e ka ba, ky o kone montim prej I., bashkëshortes dhe vajzës s tij dhe sot e asaj dite na kanë mshelë derën e oborrit mu dhe motrave dhe nuk kemi mujt as prindërit me i pa deri ditën e varrimit. Kurse siç kanë deklaruar edhe dy motrat e mija se i ka rreh i ka bo për spital i kanë edhe letrat e spitalit si e ka dhanë shoqja e I. se veç janë fjalosë dhe ka qenë largë njeri tjetrit dhe nuk ka pas asgjë tjetër dhe nuk po e shoh se për çka duhet të dënohem unë, kur ky me ka kërcënuar mu dhe me ka qit prej shpije.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar secilën prove veç e veç dhe te gjitha së bashku nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri V. A. ka qenë në shtëpinë e të dëmtuarit I. A. e cila gjendet në në fsh. R. Komuna e Pejë me dt.20.08.2024 në ora 16:00 të cilët kanë pasur një mosmarrëveshje lidhur me ndarjen e pronës së përbashkët ndermjet I. dhe të pandehurit V. , të cilët janë vëllezër, këtë fakt nuk e ka kontestuar as vet i pandehuri.

Është vërtetuar fakti se për deri sa i dëmtuari ishte në dhomën e babait të tij duke u kujdesur për prindin e tij, ku i pandehuri V. fillimisht hynë dhunshëm në shtëpi më pas i njëjti me qëllim të frikësimit, e kanos të dëmtuarin Is. me fjalët kanosëse “Ose nënshkruaje procesin e ndarjes së pronës, ose kam me të prerë në fytyrë”, ku fjalët e të pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, dhe pasiguri se me të vërtetë do ti ndodh diçka e keqe nga ana e të pandehurit, e kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitareve E. A. dhe M. Ad. të dhënë në shqyrtim gjyqësor më të cilën gjykata ja ka falur besimin e plote pasi që gjeti se të njëjtat janë bindëse.

Gjykata erdhi ne përfundim se fakti se i pandehuri V. e ka kanosur te dëmtuarin I. , vërtetohet edhe me vete mbrojtjen e të pandehurit i cili tregon se ne lidhje me problemin e pronës “i ka dhënë ultimatium” të dëmtuarit, gjithashtu edhe nëse shikohet me vëmendje video incizimi i dorëzuar nga i dëmtuari shihet qartazi kur i pandehuri V. me një sjellje tepër te ashpër dhe kërcënuese i jep ultimatium këtu te dëmtuarit, i cili se bashku me familjen e tij janë te ulur ne shtëpinë e tyre.

Nga gjendja e fakteve të vërtetuara si dhe me provat e administruara personale dhe materiale-formale, gjatë këtij shqyrtimit kryesor, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri V. A. me

veprimet e tij është inkriminuar në figurën e veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së të përshkruar si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

C. Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) që e përcakton veprën penale Kanosje dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 181 par.2 të KPRK-së, përveç që përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, që është dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet , ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin V. A..

Pas analizimit të provave të bashkëngjitura lëndës dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë renduese për të pandehurin V. A. gjeti shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit ndaj të dëmtuarit I. A. të cilin dhe e ka vëlla pra brenda marrëdhënies familjare, ndërsa rrethana lehtësuese gjykata nuk gjeti në lidhje me të pandehurin.

Shkalla e lartë e dashjes nga ana e të dënuarit shprehet përmes insistimit të tij për të kryer veprën penale ndaj të dëmtuarit I., ku i njëjti fillimisht hynë dhunshëm në shtëpinë e prindërve ku jeton edhe i dëmtuari e ky i fundit ishte duke u kujdesur për prindërit e tij, ku i pandehuri fillon fjalosjen nën ndikimin e problemeve të mëparshme lidhur me pronë e gjithë kjo në prezencën të fëmijëve të mitur të cilët janë të shqetësuar tej mase duke ju ka shkaktuar frikë dhe ankthe të njëjtëve, pra duke pasur parasysh se i pandehuri e konfirmon edhe vet në mbrojtjen e tij se ka

qene i tensionuar ne te dëmtuarin pse nuk ja ka nënshkruar bartjene pronës, kjo tregon se i pandehuri me dashje direkte dhe me seriozitet e ka kanosur te njëjtin, ku thotë edhe vet se i “ka dhënë ultimatium”.

Pra i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet që do ti ndërmerri do shkaktonte një pasojë të ndaluar me ligj, mirëpo i njëjti është pajtuar dhe ka dashur që pasja të shkaktohet.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat renduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe te gjitha së bashku, raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka vendosur qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 (dymijë) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit te dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi qe të pandehurit t’i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer dhe se lartësia e gjobës është proporcionale me nivelin e rrezikut dhe dëmit të shkaktuar me veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike konform nenit 463 par. 1 dhe par. 2 të KPPRK-së, udhëzoi në kontest të rregullt civil.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.774/21, me datë 26.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.